



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT  
ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE

Nr. 504 Regj

Lushnje, më 26.07.2021

VENDIM – SHPALLJE

*(Lidhur me ekzekutimin e “Urdhërit të Ekzekutimit” të titullit ekzekutiv të debitorit)*

Në Lushnje, sot më datë 26.07.2021,

Unë Mirel Gjolena, me detyrë Përmbarues Gjyqësor pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje, pasi studiova aktet proceduriale të çështjes përmbarimore nr.504, datë 28.06.2021 bazuar në Urdherin e Ekzekutimit me nr.208, datë 25.09.2020 të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës Parë Sarandë.

K O N S T A T O V A :

Se në datë 28.06.2021 është depozituar pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje kërkesa e kreditorit Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës Parë Sarandë së bashku me Urdherin e Ekzekutimit me nr.208, datë 25.09.2020 të vendimit me nr.23-2020-542(107), datë 12.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me palë:

- Kreditor : Buxheti Shtetit
- Debitor : Sokol Qemal Hajdari
- Objekti : Gjobë Penale ne Shumen 78 400 lekë

Nga ana e Zyrës së Përmbarimit Lushnje ka filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr. Civile si dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “ Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmbrimor Gjyqësor”, i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitori Sokol Qemal Hajdari nuk ka marr dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj bazuar në nenet 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe neni 517 të

Kodit të Proçedurës Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike e debitorit lidhur me detyrimin që ka ai ndaj Buxhetit të Shtetit në vlerën 78 400 lekë.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 133/a, 133/b, dhe 144/a si dhe 517 të Kodit të Proçedurës Civile dhe ligjit nr.8730, datë 18.01.2001 “ Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbirimor Gjyqësor”, i ndryshuar.

#### V E N D O S A :

1. Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marr parasysh edhe komunimin postar), nga data 26.07.2021 – 15.08.2021 të debitorit Sokol Qemal Hajdari;
2. Ky vendim përpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në vëndbanimin e fundit të palës debitore , një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës së Përmbarimit Lushnje, një kopje dërgohet për afishim pranë në këndin e publikimeve të Njësia Administrative nr.2, Bashkia Tiranë një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Tiranë.
3. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Ilirjana Ferit Tomani me vendbanim në adresën Budi 15/a/77, Njësia Administrative nr.2, Bashkia Tiranë;
4. Pala debitore Sokol Qemal Hajdari me vendbanim në adresën Kadri Qystri, Bashkia Lushnje të paraqitet pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje në lagjen “ Çlirim” , kati i parë, hyrja mbarapa në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe të marr kontaktet me përmbaruesin gjyqësor të çështjes përmbarimore për t’iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbarimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim detyruar sipas nenit 519 e në vijim të Kodit të Proçedurës Civile.

*U shpall në Lushnje, sot më datë 26.07.2021.*

PËRMBARUESI GJYQËSOR  
Mirel Gjoleja

